



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) Rruga "MIGJENI" (ish-Banka e Lubjanës) Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel:+ 383 38 212 309 e-mail: oshp@rks-gov.net

PSH. Nr. 144/23

Paneli Shqyrtues, i emëruar nga Kryetarja e Organit Shqyrtues të Prokurimit Publik (OSHP), në bazë të nenit 105,106 dhe 117 të Ligjit për Prokurim Publik të Republikës së Kosovës (LPP), në përbërjen Vedat Poterqoi - Kryetar, Kimete Gashi - Anëtare dhe Agon Ramadani - Anetar, duke vendosur sipas ankesës së parashtruar nga Grupi i Operatorve Ekonomik (GOE) "Levantina Injenieria Y Construccion" dhe "Pro & Co Group" sh.p.k. në Graçanicë, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Ndërtimi i Rrugës A-Pjesa e Parë" evidentuar me numrin e prokurimit 616-22-7096-5-1-2, iniciuar nga Komuna e Prishtinës, në cilësinë e Autoriteti Kontraktues (AK), me 19.04.2023, mori:

V E N D I M

1. Refuzohet si e pa bazuar ankesa e GOE "Levantina Injenieria Y Construccion" dhe "Pro & Co Group" sh.p.k. me seli në Graçanicë, e parashtruar në OSHP me 17.03.2023, Protokolli 144/2023, kurse Mbetet në fuqi Vendimi i AK i datës 24.02.2023, për dhënie të Kontratës, për aktivitetin e prokurimit "Ndërtimi i Rrugës A-Pjesa e Parë" me numër të prokurimit 616-22-7096-5-1-2.
2. Konform nenit 31 paragrafi 5 i Rregullores së Punës së OSHP, konfiskohen mjetet e depozituara në emër të tarifës ankimore dhe të njëjtat kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

A r s y e t i m

- Faktet dhe rrethanat procedurale -

Me 14.07.2022, AK ka publikuar Njoftimin për kontratë, për aktivitetin e prokurimit "Ndërtimi i Rrugës A-Pjesa e Parë" me numër të prokurimit 616-22-7096-5-1-2, ndërsa me 18.11.2022 ka publikuar *Letrën standarde të kualifikimit* sipas së cilës konstatohet se në këtë aktivitet të prokurimit janë kualifikuar gjithsejtë 6/gjashtë OE.

Me 05.01.2023, është berë hapja e ofertave nga ana e AK (mes të OE të kualifikuar nga faza paraprake) me ç'rast OE tani ankuesi është renditur i treti për nga çmimi.

Me 24.02.2022, AK ka publikuar Njoftimin mbi Vendimin, sipas të cilit është rekomanduar për kontratë GOE Sallahu SH.P.K. & ALTISCONSTRUCTION LTD, në vlerë prej 8,497,801.66 €.

Me 01.03.2023, tani Ankuesi ka dorëzuar Kërkesën për ri-shqyrtimin e Vendimit të cituar si më sipër, e cila është refuzuar si e pa bazuar me Vendimin e AK të datës 08.03.2023.

Me 17.03.2023, I pakënaqur me vendimin e AK të cituar si më sipër, GOE (në përbërje dhe të dhëna të përshkruara si më sipër) ka parashtruar ankesë në OSHP, e cila është regjistruar me numër të protokollit 144/23.

Në fazën e shqyrtimit paraprak:

(a) OSHP ka konstatuar se ankesa në rastin konkret është ushtruar në pajtim me nenin 109.1 të LPP, sipas të cilit kundër çdo vendimi të marrë nga AK, çdo palë e interesuar mund të parashtrorë ankesë pas zbatimit të procedurës paraprake për zgjidhje të mosmarrëveshjeve, sikurse parashihet me nenin 108/A të këtij ligji. Meqë ankuesi ka statusin e palës së interesuar sikurse përkufizohet me nenin 105, paragrafi 1, lidhur me nenin 4, paragrafi 1.26 të LPP, kurse ankesa përmban elementet qenësore të parapara me nenin 111, të Ligjit të cituar, që do të thotë se e njëjta i plotëson kushtet në kuptim të dispozitave të cituara dhe bije nën kompetencat e këtij organi në kuptim të nenit 105, të LPP, lidhur me nenin 9, të Rregullores për Punën e OSHP.

(b) Bazuar në veprimet e përshkruara si më sipër, OSHP ka caktuar Panelin Shqyrtues sipas nenit 111, paragrafi 5 (ii) të LPP dhe ka angazhuar ekspertin shqyrtues në pajtim me nenin 111, paragrafi 5 (i) të LPP, me detyrë që i njëjti ta bëjë shqyrtimin fillestar të dosjes dhe pretendimeve ankimore, përkitazi me këtë aktivitet të prokurimit, në kuptim të nenit 113 dhe 114 të LPP lidhur me nenin 17 dhe 19 të Rregullores së cituar. Lidhur me këtë, me 28.03.2023, eksperti shqyrtues ka dorëzuar Raportin e vlerësimit rekomandime të cilat përshkruhen si në vijim:

- Ankesa të refuzohet si e pa bazuar,
- Të mbetet në fuqi vendimi i atakuar i AK i datës 24.02.2023 (*për dhënie të kontratës*).

(c) Raporti i ekspertizës i përmban elementet qenësore sikurse kërkohet me nenin 113, paragrafi 3 të LPP dhe i njëjti është pranuar nga të dyja palët, konform nenit 115 të LPP lidhur me nenin 20 të Rregullores së cituar. Në këtë rast evidentohet se Ankuesi nuk është pajtuar me raportin e cituar, kurse AK është deklaruar se pajtohet. Po ashtu konstatohet se palët janë në dijeni lidhur me shkresat kompletet kësaj lënde sikurse kërkohet në pajtim me paragrafin 2, të nenit 20 të Rregullores për Punën e OSHP, prandaj ka kushte që Paneli të vendosi në mënyrë meritore përkitazi me ankesën e ushtruar në rastin konkret.

- Administrimi dhe vlerësimi i provave -

Paneli konstatoi se nuk ekzistojnë elementet për parandalim të konfliktit të interesit, siç kërkohet në kuptim të nenit 11 të Rregullores për Punën e OSHP, prandaj analizoi të gjitha shkresat e kësaj

lënde, përfshirë të gjitha aktet dhe veprimet e palëve dhe konsideroi se nuk ka nevojë të konvokohet seanca publike me palë sepse ka prova të njaftueshme për të vendosur sipas paragrafit 1, të nenit 24 të Rregullores së cituar. Paneli në këtë rast mori në konsideratë të gjitha pohimet ankimore, aktet dhe veprimet e AK dhe raportin e ekspertit dhe konsideron se janë jo kontestuese faktet se AK ka zbatuar në këtë aktivitet të prokurimit procedurën e kufizuar, vlerë e madhe, lloji i kontratës punë, vlera e parashikuar 9,500,000.00 €, kurse me rastin e hapjes së ofertave ankuesi është renditur i treti për nga çmimi.

Në fakt (natyrisht pavarësisht nga rekomandimet) Paneli vëren se procedura e prokurimit e cila është aplikuar në këtë rast është prezantuar në detaje në raportin e ekspertit shqyrtues, duke i shpjeguar të gjitha fazat e procesit dhe veprimet e ndërmarra nga palët në kontekstin krahasues me aktet në fuqi, posaçërisht me RROUPP. Në këtë rast, duke i analizuar në tërësi shkresat e kësaj lënde vërehet se ankuesi është renditur i treti për nga çmimi, me rastin e hapjes së ofertave dhe nga ana tjetër i njëjti nuk i ka parashtruar vërejtjet eventuale në fazat përkatëse të aktivitetit të prokurimit sepse secili OE disponon me këtë të drejtë. Sidoqoftë, ankuesi ka pohuar se OE i rekomanduar nuk i ka plotësuar kushtet lidhur me kapacitetin financiar dhe pranueshmërinë e kandidatëve, mirëpo ato tani e kanë humbur kuptimin e pretendimit prandaj Paneli mbështet mendimin e ekspertit shqyrtues nga ky aspekt sipas të cilit, cituar: "...ankuesi e ka humbur afatin ligjor për të paraqitur pretendime ankimore sa i për këtë përshtatshmërisë së kandidatëve, kritereve të përzgjedhjes apo ndaj çdo kërkesë të paraparë në dokumentin e para-kualifikimit sepse AK e ka mbyllur *fazën e parë* duke i njoftuar të gjithë OE të cilët janë të përfshirë në listën e kualifikimit përmes Letrës standarde të kualifikimit dhe ndaj këtij njoftimi nuk kishte pranuar asnjë kërkesë për ri-shqyrtim".

Në përmbledhje të fakteve dhe rrethanave nëpër të cilat ka kaluar aktiviteti i prokurimit në rastin konkret (pa nevojë që ato të përshkruhen sërish, përderisa të njëjtat janë të njohura për ankuesin), në raportin e cituar theksohet me të drejtë se një kërkesë *konsiderohet të jetë formalisht e plotësuar nëse i plotëson të gjitha kërkesat formale në dokumentet e para-kualifikimit* duke shpjeguar më tej se pranueshmëria e kandidatëve, kriteret e përzgjedhjes vlerësohen në fazën e parë, kurse AK e ka publikuar listën e kualifikimit të OE konform nenit 49.15 të RROUPP-së pasi që ka bërë vlerësimin e pranueshmërisë dhe kualifikimit të kandidatëve dhe i ka njoftuar kandidatët të cilët janë pjesë e listës së ngushtë dhe për këtë mbetet përgjegjësi e vetë autoritetit kontraktues. Më tej eksperti shqyrtues ka shpjeguar me të drejtë se në fazën e dytë bëhet vetëm vlerësimi formal konform nenit 49.26, (RROUPP-së) pra vlerësohet oferta financiare apo përshkrimi i çmimit, formulari i tenderit apo siguria e tenderit andaj me të drejtë ka theksuar se AK ka vepruar konform nenit 59 të LPP-së pasi në *fazën e dytë* ka vlerësuar vetëm ofertën financiar në bazë të kriterit të dhënies së kontratës dhe jo kriteret e përzgjedhjes dhe përshtatshmërinë e kandidatëve sepse atë e ka bërë në fazën e parë.

Prandaj duke ju referuar nenit 104.1, të LPP, sipas të cilit kërkohet që procedura e shqyrtimit të zbatohet në mënyrë të shpejt, të ligjshme dhe efektive dhe duke i analizuar po ashtu në tërësinë e tyre shkresat e kësaj lënde në kontekstin e këtij procesi të prokurimit, Paneli nuk e konsideroi të

nevojshme ta shtjelloj sërish në detaje dhe pa nevojë në këtë rast secilin pretendim ankimor, përdërisa të njëjtat në mënyrë specifike janë veçuar sidomos në vendimin e atakuar të autoritetit kontraktues dhe janë analizuar dhe argumentuar pa vërejtje nga ana e këtij Paneli. Krahas tjerash, në vendimin e atakuar të autoritetit kontraktues dhe në raportin e ekspertit shqyrtues janë dhënë shpjegime të drejta po ashtu edhe lidhur me pohimet ankimore përkritazi me deklaratën e garancionit, përmbajtjes dhe vulosjes së sajë. Duke i analizuar pohimet dhe vërejtjet e ankuesit lidhur me deklaratën e garancionit, respektivisht elementeve teknike të saj, Paneli vëren se arsyet e dhëna në vendimin e atakuar të autoritetit kontraktues janë profesionale dhe të argumentuara pa vërejtje me prova materiale, pa nevojë që të përshkruhen sërish. Prandaj Paneli mbështet shpjegimet e ekspertit shqyrtues i cili ka shpjeguar se në dosje të tenderit nuk ishte kërkuar që të dorëzohet ndonjë format i caktuar i garancionit dhe se deklarata e dorëzuar nga GOE të rekomanduar për kontratë, konsiderohet e pranueshme sepse përmban të dhënat e kompanisë së rekomanduar siç janë emri i kompanisë, numër i biznesit, pronari, nënshkrimi dhe përputhen me ato të paraqitura në vulë.

Ankuesi ka pohuar po ashtu se AK nuk i ka siguruar qasje të lirë dhe të papengueshme në dokumentacionin e prokurimit, posaçërisht në dokumentacionin e GOE të propozuar për kontratë. Edhe nga ky aspekt, eksperti ka pasur të drejtë në shpjegimet e dhëna nga ana e tij/sajë se ankuesi nuk e ka specifikuar se në cilën fazën ka kërkuar qasje në dokumente publike, në dokumentet e para kualifikimit (fazës së parë) apo në fazën e dytë ftesës për tenderim (dosjen e tenderit). Eksperti shqyrtues ka shpjeguar se nga dokumentet e listuar në ankesë vërehet se OE ankues i ka pranuar të gjitha dokumentet gjatë qasjes në dokumente publike mbi të cilat bëhet vlerësimi i fazës së dytë. Në kontekstin e këtyre shpjegimeve dhe njëherësh bazuar në shkresat e kësaj lënde Paneli mbështet raportin e ekspertit shqyrtues.

Prandaj bazuar në faktet dhe rrethanat e shpjeguara shkurtimisht si më sipër, Paneli konsideron se AK nuk ka vepruar në kundërshtim me nenin 7 të LPP, sepse në shkresat e kësaj lënde nuk gjendet ndonjë provë se AK ka aplikuar ndonjë kriter apo veprim që diskriminon, redukton apo eliminon konkurrencën në mes të operatorëve ekonomik. Ankuesi ka theksuar në vijim se cituar: "...ky veprim përbën shkelje të plotë edhe të nenit 1 dhe 6 të LPP-së duke tentuar të bëjë shfrytëzim jo efikas dhe jo transparent të parasë publike dhe duke tentuar që mjetet financiare të i shfrytëzojë në mënyrën më jo ekonomike të mundshme". Mirëpo nga shqyrtimi i shkresave të kësaj lënde dhe i rrjedhës së prokurimit, Paneli nuk gjeti ndonjë provë sipas së cilës mund të konstatohet synimi i AK për shfrytëzim jo efikas dhe jo transparent të parasë publike. Ankuesi ka pohuar më tej se AK ka shkelur nenin 10 (Mjetet për promovimin e Transparencës) të LPP, mirëpo edhe në këtë rast, bazuar paraprakisht në shkresat e kësaj lënde, Paneli konsideron se nuk ka shkelje në dispozitës së cituar, pa nevojë për ti përsëritur shpjegimet si më sipër.

Ankuesi ka pohuar se AK ka shkelur nenin 59 të LPP-së pasi që gjatë vlerësimit të tenderëve nuk iu ka përmbajtur dispozitave të këtij neni dhe ka shkelur nenin 60 të LPP-së pasi që nuk ka respektuar si duhet paragrafin 1.2 dhe 2 të këtij neni gjatë procesit të vlerësimit, krahasimit dhe poentimit të tenderëve dhe po ashtu ka shkelur nenin 65 të LPP-së pasi që ka shpërblyer me

kontrate një OE të pa përshtatshëm e që rrjedhimisht është edhe i pa përgjegjshëm. Në kontekstin e këtyre pohimeve Ankuesi ka theksuar mes tjerash se ka *shumë mangësi*, megjithatë Paneli konsideron se pohimet e kësaj natyre, në mungesë të provave bindëse, nuk janë të mjaftueshme për aprovimin e një ankese dhe/ose anulimin e një vendimi të AK apo të aktivitetit të prokurimit. Mirëpo, bazuar në faktet dhe rrethanat procedurale të prezantuara si më sipër, konstatohet se:

- është jo kontestues fakti se AK me 14.07.2022, ka publikuar Njoftimin për kontratë (për aktivitetin e prokurimit të përshkruar si në hyrje të këtij vendimi) ndërsa me 18.11.2022 ka publikuar *Letrën standarde të kualifikimit* sipas së cilës janë kualifikuar gjithsejtë 6/gjashtë OE;

- është jo kontestues fakti se me 05.01.2023, është berë hapja e ofertave, me ç'rast OE tani ankuesi është renditur i treti për nga çmimi;

- është jo kontestues fakti se me 24.02.2022, AK ka publikuar Njoftimin mbi Vendimin, sipas të cilit është rekomanduar për kontratë GOE Sallahu SH.P.K. & ALTISCONSTRUCTION LTD, në vlerë prej 8,497,801.66 €;

Prandaj Paneli konsideron se faktet e cituara si më sipër kanë efekt qenësor lidhur me marrjen e vendimit të AK, sepse:

- Është aplikuar kriterit *Tenderi i përgjegjshëm ekonomikisht* më i favorshëm, sikurse kërkohet shprehimisht me dispozitën e nenit 52 të LPP, sipas të cilit, cituar: “Autoriteti kontraktues në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit do të specifikoj kriteret që do të përdoren për dhënie të kontratës. Kriteret duhet të jenë ose çmimi më i ulët ose tenderi ekonomikisht më i favorshëm”.

- AK ka vepruar në pajtim me nenin 59 të LPP, sepse nuk ka aplikuar ndonjë ndryshim material në dosjen e tenderit sikurse parashihet me paragrafin 2, të nenit të cituar sipas të cilit “Asnjë ndryshim material dhe asnjë aspekt i tenderit nuk duhet të kërkohen ose pranohen nga autoriteti kontraktues ose të ofrohen nga një tenderues”.

- Ankuesi është renditur i treti për nga çmimi, kurse AK ka zbatuar drejtë nenin 60 të LPP, sipas të cilit “Autoriteti kontraktues do t’ia jap kontratën publike operatorit ekonomik që ka dorëzuar tenderin e përgjegjshëm me çmimin më të ulët; tenderin ekonomikisht më të favorshëm në bazë të kriterëve dhe peshën që është specifikuar në dosjen e tenderit sipas nenit paragrafit 3. të nenit 52 të këtij ligji”.

- *Përfundim* -

Nisur nga shpjegimet si më sipër Paneli konsideron se AK ka vepruar në harmoni me dispozitat e cituara si më sipër të LPP dhe ka zbatuar drejtë dosjen e tenderit sikurse parashihet me paragrafin 1, të nenit 27, sipas të cilit, autoriteti kontraktues përpilon dosjen e tenderit me të gjitha informatat përkatëse përfshirë të gjitha termet dhe kushtet materiale të saj, procedurat e zbatueshme të prokurimit, çfarëdo kërkesë të aplikueshme të përshtatshmërisë ose ndonjë kriter të përzgjedhjes, procedurat e ankesës si dhe informatat e tjera përkatëse siç kërkohen nga ky ligj ose siç i shihet të domosdoshme autoriteti kontraktues. Në kuptim të kësaj dispozite, dosja e tenderit përbën dokumentin kryesor të prokurimit dhe se publikimi i sajë supozohet të jetë në harmoni të plotë me

qëllimet e LPP, të siguroj mënyrën efikase të shfrytëzimit të fondeve publike, të promovoj integritetin e vet procesit të prokurimit dhe të kulturës institucionale dhe të profesionalizuar.

Ndonëse mendimi i ekspertit nuk është detyrues, Paneli sipas mendimit të pavarur të tij e ka mbështetur raportin e ekspertit në rastin konkret, nisur nga parimi se vlera provuese e tij jepet gjithnjë me raport me vlerësimin, krahasimin dhe administrimin e të gjitha provave tjera dhe natyrën e një çështje në rastin konkret.

Paneli shqyrtues konsideron se vendimi i marrur në këtë çështje është i bazuar në administrimin e të gjitha provave, në dispozicion të kësaj lënde dhe se në marrjen e vendimeve gjithmonë ka parasysh nenin 1 të LPP-së, ku qëllimi i këtij ligji është të siguroj mënyrën më efikase, më transparente dhe më të drejtë të shfrytëzimit të fondeve publike, burimeve publike si dhe të gjitha fondeve dhe burimeve të tjera të autoriteteve kontraktuese. Paneli Shqyrtues niset gjithnjë nga fakti se autoritetet kontraktuese ushtrojnë pavarësinë e tyre institucionale në procesin e prokurimit publik, mirëpo mbetet në detyrimin e tyre eksplicit respektimi i ligjshmërisë në procesin e prokurimit.

Andaj nga të lartcekurat, paneli shqyrtues në pajtim me nenin 117 të LPP-së vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Kryetari i Panelit Shqyrtues
Vedat Poterqoi



Këshillë Juridike:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur ka të drejtë që t'i drejtohet Gjykatës Komerciale në Prishtinë në afat prej 30 ditësh, nga data e pranimit të këtij vendimi.

Vendimi t'i dorëzohet:

- AK-Komuna e Prishtinës
- GOE "Levantina Ingenieria Y Construccion si dhe Pro & Co Group sh.p.k. Graçanicë
- Arkivës së OSHP-së;
- Për publikim në ueb-faqe zyrtare;